

e sipër. I çuan te vendi i quajtur *Koritë Uji/Pojilo* [vendi ku banorët e Rahovecit/Orahovac e çonin bagëtinë në kullotë], i cili është dy kilometra larg nga qyteti, në drejtim të Malishevës/Mališevo. Aty i kishte parë Jovan Lukić, të cilin e sollën më vonë [të shikohet regjistrimi më poshtë]. Të gjithë të burgosurve, serbëve si dhe romëve, të cilët, gjithashtu, ishin ndaluar po atë ditë, u vuan kapelat në kokë dhe i çuan në burgun e UÇK-së në Malishevë/Mališevo [godina e re e braktisur e policisë]. Nga ky vend, më **18.07.1998**, i çuan në grupe të ndara në një pyll, që ishte jo shumë larg **Malishevës/Mališevo**. Nga kjo ditë, dy zjarrfikësve serb u humbet çdo gjurmë. Mbetjet e tyre mortore u zbuluan në muajin maj të vitit 2005, në varrezën masive përkaj spitalit në Malishevë/Mališevo. U identifikuan më 7.04.2006, me analizën e ADN-së. Që të dy u varrosen në Serbi, Đorđe në Kralevē, ndërkaq Duško në Jagodinë.

**Burimet:** deklarata J.L, FDH-455; deklarata M.D, FDH-456; deklarata M.D, FDH-470; deklarata V.V, FDH-862; deklarata S.S, FDH-5690; deklarata V.M, FDH-5693; deklarata P.B, FDH-6090; deklarata Z.G, FDH-18940; *Preuzeta tela 11 Srba*, Večernje Novosti, 08.04.2006, FDH-27921; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 347, 351; AIS, *Zona...*, 62, FDH-16913; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Teroristički...*, III, 83-88, 90-93, 973; *Sahranjeni posmrtni ostaci otetih*, Oteta istina, num. 8, prill-qershor 2006, 8, FDH-19942; *Šta je sa otetima*, Ilustrovana politika, 28.11.1998, 7-8, FDH-32281.

## Ibrahim (Adem) Cena

(3.02.1947, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, punëtor, tre fëmijë)

Ibrahimi punonte në Shtëpinë e Kulturës në **Rahovec/Orahovac**. Jetonte në lagjen *Strana*, në mes të stacionit të autobusëve dhe pikës së karburanteve *Jaha Petrol*. Ibrahimi ishte ndarë nga bashkëshortja e mëparshme. Djemtë, Admirin dhe Mizairin, i kishte në mërgim, ndërkaq e bija Mirsada ishte e martuar. Kur në qytet filluan të dëgjoheshin të shtënat [17.07.1998], Ibrahimi gjendej në oborrin e shtëpisë së vetë. Papritmas, e ka qëlluar

një plumb. Komshiu i tij Selajdini e ka çuar menjëherë me traktor në Shtëpinë e Shëndetit, ku ai, pas pak, dha shpirt. Në të njëjtën natë, i vëllai Asllani e ka varrosur Ibrahimin në arën e vet, në afërsi të vendit të quajtur *Te Rrasat/Ploče*. Në datën 5.10.1998, pasi e siguruan lejen e kryetarit të komunës, Anđelko Kolašinac, familjarët e kanë varrosur Ibrahimin në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

**Burimet:** deklarata A.C, FDH-851; deklarata N.N, FDH-877; deklarata N.V, FDH-880; deklarata A.C, FDH-35288; *Rahovec in Flames and Smoke Amidst Continued Serb Shelling*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372.

## Srećko (Živojin) Vitošević

(16.02.1968, serb nga Rahoveci/Orahovac, punëtor)

Në datën **17.07.1998**, rreth orës 17:15, Srećko me kushëririn Jovan Lukićin u nisën me makinë për një vizitë te djali i Jovanit, i cili gjendej në Gjakovë/Đakovica, ku e kryente shërbimin e rregullt ushtarak. Në dalje të **Rahovecit/Orahovac**, ata u ndalën nga ushtarët e UÇK-së. Pas legjitimitit, i nxorën jashtë makinës, i futën në një furgon të bardh dhe i çuan te vendi i quajtur *Koritë Uji/Pojilo*. Më pas, së bashku me serbë dhe romë të tjerë të ndaluar, i çuan në burgun e UÇK-së në **Malishevë/Mališevo**. Srećko ishte i mbyllur në të njëjtin dhomë me Jovanin. I keqtrajtuat fizikisht tërë natën. Me torturë u vazhdua edhe të nesërmen. Srećko Vitošević dhe Jovan Lukić u nxorën nga burgun në datën **18.07.1998**, diku pas orës 20:00. Në grup me ta ishin Srđan Vitošević, Aleksandar Stanojević dhe Dušan Patrnogić [të shikohen regjistrimet në vijim]. I futën në furgon dhe i çuan në drejtim të Prishtinës/Priština. U ndalën te pyjet e para të Malishevës/Mališevo. I çuan të burgosurit deri te një vend, ku ishin të hapura disa gropa, afro 50 metra larg rrugës së asfaltuar. U thanë se në ato gropa kanë përfunduar "serbët e juaj" [grupi i parë] dhe se edhe ky grup do të përfundonte në të njëjtën mënyrë. Jovani ka shpëtuar në rrethana misterioze. Në muajin maj të vitit 2005, mbetjet mortore të Srećkos u zbuluan në varrezën masive, në afërsi të